



Mini projekti ynë
në Zonën e
Mbrojtur të
Posaçme me
Rëndësi për
Mesdheun
(SPAMI)

©Conservatoire du Littoral

SPAMIday
15 April

“
**Zbulojmë
thesaret e Parkut
Kombëtar Detar
Karaburun-Sazan**
”



Ku

Parku Kombëtar Detar Karaburun-Sazan është parku i parë detar në Shqipëri, përfshin një sipërfaqe prej 12,437.7 hektarësh dhe është shtëpia e shumë habitateve dhe specieve të rëndësishme. Së fundmi, një tjetër qasje menaxhimi është aplikuar për parkun, ku një shoqatë lokale, Flag Pine, e bashkë-menaxhon atë së bashku me Administratën e Zonave të Mbrojtura Vlorë.

Çfarë pritet

Ky projekt synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe të promovojë mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit në PKD Karaburun-Sazan. Objektivat specifike përfshijnë ndërgjegjësimin për rëndësinë e parkut detar, përfshirjen e të rinjve në edukimin mjedisor dhe promovimin e listës SPAMI. Aktivitetet përfshijnë prodhimin e materialeve ndërgjegjëse duke përdorur sloganin #NeJEMISPAMI, organizimin e aktiviteteve me shkolla në Qendrën e Vizitorëve dhe Qendrën e Rehabilitimit të Breshkave Detare, krijimin e muraleve dhe hapësirave të dedikuara për edukimin mjedisor në një shkollë pilote.

Partneritetet dhe Të ardhurat

Ky mini projekt do të implementohet nga Flag Pine në bashkëpunim me AdZM Vlorë. Të ardhurat do të sigurohen me kontribut in kind të Flag Pine dhe SPA/RAC, përmes Programit SPAMI Twinning, i implementuar në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Sekretariatit-UNEP/MAP të Konventës së Barcelonës dhe Ministrisë Italiane të Mjedisit dhe Sigurisë Energjitike.

Bashkohuni me ne

Ftojme të gjithë të bashkohen me ne në promovimin e ruajtjes së biodiversitetit në Parkun Kombëtar Detar Karaburun-Sazan duke vizituar parkun, duke u përfshirë në edukimin mjedisor dhe duke mbështetur aktivitetet konservuese.

Mos humbisni festimet
e **15 Prillit !!**



Kontakttoni Flag Pine për më shumë informacion se si mund të përfshihen:

 @flagpine

 flagpine7@gmail.com

